



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. ~~1968~~ Prot.
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 30.12.2022

URDHËR

Nr. 219 datë 30/12/2022

**PËR NGRITJEN E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT
DHE RESPEKTIMIT TË RREGULLAVE TË ETIKËS**

Në mbështetje të ligjit nr.9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", të ligjit nr.13, datë 18.2.2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ligjit nr.10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", të Vendimit nr.714, datë 22.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike", të Vendimit nr.625, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e manualit të etikës në ofrimin e shërbimeve publike në sportel", të Vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Udhëzimit nr.8, datë 13.03.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, Statutit dhe Rregullores së brendshme të institucionit,

URDHËROJ

1. Ngritjen e autoritetit përgjegjës për monitorimin e zbatimit dhe respektimit të rregullave të etikës.
2. Caktimin e:
 - a) z. Eduard Meçaj, me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore,
 - b) z. Agim Alia, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Vlerësimit,
 - c) z. Seldi Beta, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Provimeve të Shtetit,si anëtarë të njësisë autoritet përgjegjës monitorimin e zbatimit dhe respektimit të rregullave të etikës.
3. Drejtuesi i njësisë autoritet përgjegjës caktohet z. Eduard Meçaj. Drejtuesi i njësisë bën ndarjen e punës mes anëtarëve.

4. Njësia e ngarkuar në pikën 1 të këtij Urdhri si autoritet përgjegjës do të monitorojë në vijimësi zbatimin dhe respektimin e rregullave të etikës.
5. Rregullat e etikës dhe sjelljes duhet të zbatohen nga të gjithë punonjësit e institucionit, në çdo ambient, në çdo pozicion e natyrë pune (në punë, në trajnime, në seminare), gjatë të gjithë orarit zyrtar, në të gjitha ditët e javës.
6. Në rastet kur do të vërehen shkelje të rregullave të etikës, eprori direkt duhet:
 - a) t'i komunikojë stafit rëndësinë e respektimit të rregullave të etikës, duke kërkuar ndryshim të menjëhershëm në mënyrën e veshjes apo të sjelljes në ditë në vijim, në rastet kur këto nuk përbëjnë shkelje të rënda me pasoja;
 - b) të marrë masa konkrete në rast se diskutimi është bërë tashme me këtë staf dhe ai/ajo vazhdon të mos respektojë rregullat e përcaktuara dhe të bëra me dije;
 - c) të raportojë pranë AP për monitorimin e zbatimit dhe respektimit të rregullave të etikës në adresën elektronike zyrtare, në rast sjellje të përsëritur. Rasti do të jetë për diskutim dhe vendimmarrje në këtë strukturë.
7. Gjithashtu në rast se identifikimi i shkeljes nuk vjen nga eprori direkt, por nga qytetarë, biznes, apo palë të treta, (ankesë e shprehur), këto subjekte, mund të raportojnë gjithashtu, edhe pranë AP, (e-mail apo çdo e dhënë kontakti), i cili analizon situatën mbi shkelje e bërë dhe mungesën e raportimit nga eprori direkt.
8. Për shkelje të rregullave të etikës, kur ato nuk përbëjnë vepër penale, zbatohen masat disiplinore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, sipas hierarkisë së normave.
9. Urdhri nr. 135, datë 23.12.2021, "Për ngritjen e AP për monitorimin e zbatimit dhe respektimit të rregullave të etikës", në QSHA, shfuqizohet.
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri anëtarët e AP.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Aurora BALLIU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Konceptoi: A. ALIA; E. MEÇAJ

Bulevardi Zhan D'Ark, nr. 23, Tiranë

Web site: www.qsha.gov.al

E-mail: Aurora.Balliu@qsha.gov.al